| 24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës | <p>1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.</p> <p>2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.</p> <p>Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor; b) garanci bankare; c) garanci nga shoqëri sigurimi. |

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike..

Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon vendimin përfundimtar për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti/ Enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;

e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Formulari i Ofertës ekonomike, për procedurat e prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët nga operatori ekonomik

Shtojca 3: Listat e Çmimeve të artikujve

Shtojca 4: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 5: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Sasisë dhe Grafikut i lëvrimit

Shtojca 8: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 9: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁴

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontratës;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

⁴ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

[Në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët, nga operatori ekonomik plotësohet dhe paraqitet vetëm kjo Shtojcë]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt: **[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

ç) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

6. Kushtet e Veçanta të Kontratës.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute është si më poshtë:

1	2	3
Nr.	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit e shprehur ne vlerë absolute

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Kujdes: Bazuar në parashikimet e nenit 45/2.1 të VKM Nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, kur si kriter vlerësimi përdoret “oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët”, autoriteti/enti kontraktor përlllogarit çmimin bazuar në:

- a) çmimin e bursës, së datës kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date
- b) elementet fiskale;
- c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës;

Shtojca 3.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** _____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):**
_____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në këtë Formular duhet të plotësohen dhe t'u vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa vlerë do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

1	2	3	4	5	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njesi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Data _____	

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së.*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e *[emri i autoritetit/entit kontraktor]* vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në *[njoftimin e kontratës]*.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 5.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publike dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit**Nënshkrimi****Vula**

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj: Sipas shtojces se specifikimeve teknike

Specifikimi i Materialeve: Sipas shtojces se specifikimeve teknike

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to: Sipas shtojces se specifikimeve teknike

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Tabela e përmbajtjes

Regjistrimi i ndryshimit të dokumentit	Gabim! Shenja e referimit e padefinuar.
Tabela e përmbajtjes.....	23
1 Hyrje	27
1.1 Te pergjithshme	27
1.1.1 Gama e Furnizimit	27
1.2 Qëllimi	27
1.3 Ofertat dhe Vlerësimi.....	27
1.3.1 Menyra e ofrimit	27
1.3.2 Menyra e realizimit	28
1.3.3 Matrica e Pajtueshmërisë	28
1.4 Përkufizimet	28
1.5 Referencat.....	28
2 Kërkesa e Përgjithshme.....	29
2.1 ARM (Disponueshmëria , Besueshmëria, Mirëmbajtja)	29
2.1.1 Disponueshmëria	29
2.1.2 Besueshmëria.....	29
2.1.3 Mirëmbajtja.....	29
2.2 Mjedisi.....	29
2.3 Furnizimi me energji elektrike	30
2.4 Instalime elektrike.....	30
2.5 Mjedisi Ambient.....	30
2.5.1 Kushtet e Operimit.....	30
2.5.2 Mjedisi jo funksional (transporti, magazinimi)	30
2.6 Dokumentacioni.....	30
3 Kërkesa e përgjithshme e Sistemit VCS.....	32

3.1	Arkitektura e Sistemit	32
3.2	Jo bllokues.....	32
3.3	Mirëmbajtja dhe aksesit.....	33
3.4	Përmirësimet e ardhshme.....	33
3.5	Pjesë këmbimi	33
3.6	Pajisjet e testimit dhe matjes.....	33
4	Kapaciteti VCS	34
4.1	Kapaciteti i sistemit.....	34
4.2	Kërkesat Funktionale	35
4.3	Pozicionet e punës së Kontrollorit (CWP)	35
4.3.1	Ndërfaqja grafike e përdoruesit.....	36
4.3.2	Kontroll i integruar i regjistrimit	36
4.4	CWP - Funkcionet dhe veçoritë e Telefonisë dhe Intercom.....	36
4.4.1	Buton me akses të drejtpërdrejtë.....	36
4.4.2	Buton me akses indirekte.....	37
4.4.3	Përcjellja e thirrjeve.	37
4.4.4	Transferimi i thirrjeve.....	37
4.4.5	Marrja e thirrjeve selektive.....	37
4.4.6	Konferenca.	37
4.4.7	Mbajtja e thirrjes.....	37
4.4.8	Gjurmimi i Linjes.....	37
4.4.9	Monitorimi i pozicionit / Monitorimi i linjës.	37
4.4.10	Përgjigje selektive në radhën e thirrjeve.....	38
4.4.11	Rithirrja e numrit të fundit.	38
4.4.12	Realizim i thirrjeve me numeracion të shkurtuar	38
4.5	CWP – Funkcionet dhe veçoritë e radios	38
4.5.1	Karakteristikat e radios për aplikacione komplekse	38

4.5.2	Modaliteti i monitorimit (Rx) / Modaliteti i trafikut (Tx)	38
4.5.3	Kontrolli i PTT	38
4.5.4	Tregues PTT aktiv diku tjetër.....	38
4.5.5	Ndalim i Squelch.....	38
4.5.6	Tregimi i kanalit radiofonik "Jashtë shërbimit"	39
4.5.7	Afishimi alfanumerik i radiofrekuencave	39
4.5.8	Parandalimi i kanaleve të pamonitoruara.....	39
4.5.9	Frekuenca Shto dhe Fshi	39
4.5.10	Bllokim PTT	39
4.5.11	Përzgjedhja manuale e Transmetuesit/Marrësit kryesor/dytësor.....	39
4.5.12	Përcjellja e roleve	39
4.6	CWP – Funksonet dhe veçoritë operationale	39
4.6.1	Zgjedhja e kufjeve/altoparlantëve për frekuencë	39
4.6.2	Zgjedhja e kufjeve/altoparlantëve për komunikimet A/G dhe G/G	39
4.6.3	Zgjedhja e aparatit / altoparlantit për komunikimet A/G- dhe G/G	40
4.6.4	Direktoria telefonike	40
4.7	Specifikimet e ndërfaqes.....	40
4.8	Aftësitë e rrjetit – ndërlidhje standarde e hapur	40
4.9	Sistemi i Monitorimit dhe Kontrollit Teknik.....	40
4.10	Sinkronizimi i kohës me GPS	41
5	Kërkesa e përgjithshme e sistemit VCR.....	42
5.1	Arkitektura e Sistemit	42
5.2	Mirëmbajtja dhe aksesit.....	42
5.3	Përmirësimet e ardhshme.....	42
5.4	Pjesë këmbimi	43
5.5	Pajisjet e testimit dhe matjes.....	43
6	Aftësia VCR.....	44
6.1	Kapaciteti i sistemit.....	44

6.2	Kërkesat Funksionale	44
6.3	Aftësitë e rrjetit.....	45
6.4	Regjistrimi audio	45
6.5	Video Regjistrimi.....	45
6.6	Dualiteti i sistemit	46
6.7	Sinkronizimi i kohës me GPS	46
7	SHËRBIMET.....	47
7.1	Kontrolli ne terren.....	47
7.2	Instalimet	47
7.3	Integrimi.....	47
7.4	Testimi dhe vënia në punë.....	47
7.5	Transporti.....	47
7.6	FAT dhe SAT	47
7.6.1	Testi i pranimet në fabrikë (FAT).....	48
7.6.2	Testi i pranimet të sitit (SAT).....	48
7.7	Trajnimi	48
7.8	Sigurimi i Përgjithshëm i Cilësisë.....	48
7.8.1	Standardet e Cilësisë	49
8	SHTOJCA A: Lista e Furnizimit	50
8.1	Sasia dhe grafiku i levrimit	50

Hyrje

Te përgjithshme

Ky dokument ofron një përmbledhje teknike të Sistemit të Kontrollit të Komunikimeve Zanore, Sistemit të Regjistrimit të Komunikimeve Zanore dhe shërbimeve përkatëse që duhet të propozohen për Albcontrol në Kullën e Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës. Projekti duhet të realizohet me celesa në dore dhe kontraktori do të jetë përgjegjës për kontrollin në terren, projektimin, furnizimin, instalimin, integrimin, testimin dhe komisionimin e të gjitha nën-sistemeve dhe trajnimet e lidhura si dhe suportin.

Garancia e përfshirë me materialet, pajisjet dhe shërbimet duhet të jetë dy vjet.

Sistemi i propozuar i Komunikimit me Zë dhe Sistemi i Regjistrimit të Zërit duhet të reflektojë zgjidhjen më të fundit në dizajnin, teknologjinë dhe instalimin si dhe suportin e bazuar me celesa në dore.

Gama e Furnizimit

1. Sistemi i Komunikimit është i krijuar nga nënsistemet e mëposhtme:
 - a. VCS Sistemi (Sistemi i komunikimit Zanor)
 - b. Sistemi VCR (Sistemi i regjistrimit Zanor)
 - c. Pjesë Rezervë
 - d. Mjetet dhe Pajisjet Testuese
 - e. Trajnimi

Qëllimi

Ky dokument identifikon kërkesat për një sistem VCS dhe VCR për t'u instaluar në Kullën e Vlorës dhe për t'u integruar me Stacionin e Ri të Radiove që do të instalohet në Stacionin e Karaburunit dhe në stacionin lokal në Kullën e Vlorës. Gjithashtu sistemi VCS do të lidhet me sistemin VCS në ACC të Tiranës nëpërmjet VOIP.

Të gjitha nënsistemet duhet të jenë të ndërveprueshëm dhe të integruara plotësisht në një sistem të vetëm komunikimi që funksionon sipas standardeve të ICAO

Ofertat dhe Vlerësimi

Në rast se tenderuesi identifikon një konflikt midis kërkesave të këtij specifikimi dhe standardeve të listuara në Referenca, tenderuesi duhet të identifikojë qartë konfliktin dhe të paktën t'u përgjigjet kërkesave në këtë dokument.

Mund të ofrohet gjithashtu një përgjigje ndaj kërkesës kontradiktore.

Menyra e ofrimit

Të gjitha referencat për implikimet e kostos dhe detajet specifike të kostos do të shfaqen vetëm në ofertën komerciale, jo në përgjigjen teknike.

Informacioni ose të dhënat e shfaqura në përshkrimet e propozimit dhe specifikimet do të referohen me secilin nga paragrafët e këtij specifikimi dhe do të shihet pajtueshmëria e tyre.

Menyra e realizimit

Kontraktori do te realizoje me celesa ne dore sistemet VCS dhe VCR per kullen e Vlores. Gjithashtu do te suportoje Albcontrol ne integrimin e ktyre sistemeve me Radiot VHF ne kulle dhe Stacionin Karaburun.

Realizimi do te kryhet per nje periudhe kohe 6-8 muaj.

Matrica e Pajtueshmërisë

Pajtueshmëria me specifikimet eshte e detyrueshme përveç rasteve kur mund të demonstrohet se ndryshimi nga kërkesat e specifikimeve tender ka ofruar avantazhe teknike ose për të ofruar avantazhe në terma të kostos pa degradim në performancë. Pajtueshmëria ndaj specifikimit kërkohet të jetë e kuptueshme dhe e ndertuar ne nje Përmbledhje të Pajtueshmërisë së plotë.

Përkufizimet

1. Përdorimi i fjalës 'Do te' tregon një kriter të mandatuar.
2. Përdorimi i fjalës 'Duhet' (dhe fraza të tilla si 'Rekomandohet që... ', etj.) tregojnë se procedura ose kriteri konsiderohet si opsioni i preferuar.
3. 'Tenderues' nënkupton operatorin ekonomik qe merr pjese ne tender.
4. 'Kontraktor' nënkupton tenderuesin e suksesshëm të cilit i është dhënë kontrata që rrjedh nga tenderi.

Referencat

- [1] ICAO ANEX 10 Volume III part 2 – Voice Communication Systems
- [2] EUROCAE ED-136 VOIP Operational and Technical Requirement
- [3] EUROCAE ED-137 Interoperability Standards for VOIP ATM Components (Radio, Telephone, recording, supervision)
- [4] EUROCAE ED 138 Network Requirements and Performance Part 1 & Part 2

Kërkesa e Përgjithshme

ARM (Disponueshmëria , Besueshmëria, Mirëmbajtja)

Disponueshmëria

Disponueshmëria do të jetë më shumë se 99,99995 % për të gjithë sistemin si dhe për lidhjet telefonike dhe ato me Radiot.

Besueshmëria

Duke qenë se VCS dhe VCR janë pajisje kritike, ato duhet të kenë një besueshmëri shumë të lartë. Dështimi i çdo komponenti të vetëm do të nënkuptojë, më së shumti, humbjen e vetëm një qarku të jashtëm telefonik ose radio, ose një pozicioni operatori, ose një kanal të vetëm regjistrimi. Një dështim i vetëm brenda të gjitha pjesëve të tjera të sistemit nuk do të ndikojë në funksionimin normal të VCS dhe VCR.

Mirëmbajtja

Sistemi i ofruar VCS dhe VCR do të përdorë konceptin e mëposhtëm të mirëmbajtjes:

Defektet brenda VCS dhe VCR do të zbulohen automatikisht dhe do të identifikohen deri në nivelin e nderfaqeve ose një shërbimi, duke përdorur softuer diagnostikues në kohë reale. Moshfunksionimet duhet të tregohen vizualisht në Sistemin e Monitorimit dhe Kontrollit Teknik. Të gjithë komponentët kritikë do të dublikohen me zgjedhjen automatike të komponentit të disponueshëm të sistemit.

Gjithashtu duhet të sigurohet monitorimi automatik i defekteve të të gjitha furnizimeve me energji, ndërfaqet e orës dhe alarmet e jashtme opsionale. Nëse një bord me defekt do të ndryshohet manualisht, Sistemi i Monitorimit dhe Kontrollit Teknik do të ofrojë mundësinë për të njohur këtë nderfaqe pas konfigurimit të sistemit. Nuk duhet të nevojiten rregullime manuale në bordet e sistemit.

Në monitor dhe në printer duhet të jetë i disponueshëm një skedar i regjistrimit të gabimeve për një raport të vazhdueshëm të defekteve.

Mjedisi

Pajisjet për të gjitha ndërfaqet dhe pjesët e sistemit duhet të sigurohen në rack pajisjesh të gjerë 19" , të mbyllur plotësisht, të përshtatshme për vendosje në dysheme teknologjike. Kabllot duhet të jenë në hyrjen e poshtme. Pajisjet e pozicionit duhet të instalohen në konzolat e operatorit.

Furnizimi me energji elektrike

Koncepti i furnizimit me energji duhet të përmbajë dy linja të veçanta furnizimi të parashikuara në vendndodhjen e Pajisjeve. Është parashikuar lidhja me AC 120V/230V dhe me pajisjet e furnizimit me energji të pandërprerë. Sistemi i Monitorimit dhe Kontrollit Teknik do të mbështetet me 230V AC.

Instalime elektrike

Të gjitha kabllot që hyjnë ose dalin nga kabinetet e pajisjeve të sistemit duhet të kalojnë nga fundi i pasmë i kabineteve. Kabllot duhet të jenë të etiketuar qartë.

Të gjitha kabllot e nevojshme për sistemin VCS dhe VCR do të instalohen dhe furnizohen nga kontraktori.

Mjedisi Ambient

Kushtet e Operimit

Temperatura e funksionimit:

+5°C deri +40°C me ftohje të detyruar të kabineteve të ndërfaqes (Përfshihen Sistemi i Monitorimit dhe Kontrollit Teknik)

+5°C deri +25°C pa ftohje të detyruar të kabineteve të ndërfaqes ,Lagështia: deri në 90% pa kondensim

Mjedisi jo funksional (transporti, magazinimi)

Specifikimet e mëposhtme duhet të plotësohen gjatë magazinimit dhe transportit:

Temperatura: -15°C deri +70°C Lagështia gjatë transportit: +40°C, 90%

Dridhja gjatë transportit: 0,3 mm, 10 Hz deri në 40 Hz (IEC 60068-2-6. Test Fc) 20 m/s², 40 Hz deri në 500 Hz (IEC 60068-2-6. Test Fc)

Dokumentacioni

Dokumentacioni i sistemit duhet të përfshijë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Manualët e Përdoruesit VCS dhe VCR
2. Manuali teknik i përdorimit të VCS dhe VCR për Sistemin e Konfigurimit dhe Monitorimit të Sistemit
3. Manuali i Mirëmbajtjes VCS dhe VCR
4. Të gjitha trajnimet – materiale specifike

Kërkesa e përgjithshme e Sistemit VCS

1. Pajisja e kërkuar VCS duhet të përbëhet nga dizajni modular ku çdo element kritik i sistemit duhet të dyfishohet
2. Sistemi i propozuar do të mbështesë ndërfaqe radio dhe telefonike dixhitale dhe analoge.
3. Sistemi i Kontrollit të Komunikimeve Zarore (VCCS) duhet të propozohet për të siguruar ndërfaqen e operatorit me sistemet radio dhe telefonike.
4. Një sistem menaxhimi në distancë dhe monitorimi duhet të propozohet gjithashtu për të gjithë sistemin (sistemet kryesore të komunikimit dhe sistemet ndihmëse).
5. Çdo pajisje speciale dhe pajisje testimi nevojitet të jetë prezent bashkë me pajisjen.
6. Besueshmëria duhet të jetë më e larta e mundshme, duke garantuar të paktën 20.000 orë, koha mesatare ndërmjet dështimeve (MTBF) dhe koha mesatare për riparim (MTTR) nuk duhet të jetë më shumë se 30 minuta.
7. VCS do të instalohet në dhomën e re të të dhënave të Kullës së Vlorës me qendër në Aeroportin Ndërkombëtar të Vlorës me pozicionet e punës të kontrolluesit ATC të instaluar në kabinën e Kullës dhe dhomën e Monitorimit Teknik.
8. Duhet të merren masa për të mbrojtur pajisjet nga efektet e mbirrymës ose mbitensionit.
9. Projektimi dhe ndërtimi i pajisjes nuk duhet të lejojë ndonjë ndryshim të rëndësishëm të funksionimit normal të saj për shkak të grumbullimit të zakonshëm të pluhurit në pjesët përbërëse të tij.
10. VCCS do të lidhet me stacionet e transmetuesve dhe marrësve VHF nëpërmjet ndërfaqeve IP (VOIP). Të dhënat e dhe monitorimit të radios do të komunikohen ndërmjet VCS dhe radiove nëpërmjet IP (VOIP) nëpërmjet rrjetit të transmetimit të të dhënave nga vendndodhja e radios deri në dhomën e të dhënave të Vlorës .
11. Kabineti do të pajiset me ndërfaqe primare dhe sekundare IP (VOIP), E&M (ATS MFC-R2) 4 tela ndërfaqet dhe ndërfaqet analoge telefonike për lidhje me sisteme të tjera VCS.
12. Lidhja ndërmjet VCS dhe radiove duhet të jetë nëpërmjet ndërfaqeve IP (VOIP) (të cilat mund të integrojnë të gjitha radiot nga dy sitet e Karaburunit dhe Kullës së Vlorës).
13. Pajisja e sistemit duhet të jetë modular dhe komercial i raftit.
14. Zëvendësimi i nxehtë i pllakave në rast dështimi do të jetë i mundur.
15. Sistemi duhet të ketë konfigurimin MAIN / HOT STANDBY.
16. Kontraktori do të dorëzojë licencat për të gjithë softuerin e implementuar.
17. Të gjitha sistemet duhet të kenë dy kopje të printuara manualin e përdorimit dhe manualin e mirëmbajtjes në anglisht, dhe në dy CD

Arkitektura e Sistemit

Sistemi do të përdorë një arkitekturë të shpërndarë tërësisht modulare dhe të decentralizuar me kontroll plotësisht të dubluar dhe autobusë zëri për të parandaluar dështimet edhe dështimet më të vogla që ndikojnë në funksionalitetin e sistemit. Autobusët e tepërt (të dyfishuar) do të funksionojnë vazhdimisht paralelisht në të njëjtin nivel prioriteti. Nuk do të ketë kalim ndërmjet një sistemi autobusi kryesor dhe atij të gatishmërisë. Të dy autobusët do të mbajnë paralelisht paketat zanore të dixhitalizuara të abonentëve dhe paketat e të dhënave.

Jo bllokues

VCS duhet të jetë plotësisht jo-blllokues duke ofruar kapacitet të mjaftueshëm për të ofruar akses të pakufizuar në çdo kanal komunikimi pavarësisht nga ngarkimi i sistemit.

Mirëmbajtja dhe akses

Të gjitha pjesët e pajisjeve të sistemit duhet të projektohen plotësisht modulare për heqjen dhe montimin e lehtë të të gjithë komponentëve. Modulet kryesore duhet të jenë të aksesueshme nga ana e përparme për të shmangur nevojën e mjeteve për heqjen e një moduli gjatë mirëmbajtjes dhe riparimit. VCS do të mbështesë Hot-Replacement.

Përmirësimet e ardhshme

Përmirësimet e ardhshme do të jenë të mundshme duke shtuar modulet dhe raftet e ndërfaqes dhe duke i lidhur ato me sistemin dublant kur është e nevojshme. Gjithashtu softueri i sistemit do të ketë mundësi të ndryshohet ose përditësohet. Çdo pozicion do të përmirësohet me anë të një LAN të veçantë.

Pjesë këmbimi

Ofertuesi duhet të përfshijë në ofertë një listë të pjesëve rezervë që vlerësohet se nevojiten për të garantuar funksionimin normal të të gjitha sistemeve për një vit pas skadimit të periudhës së garancisë.

Pjesë këmbimi duhet të furnizohet për të gjitha sistemet që janë pjesë e ofertës Pjesët e këmbimit duhet të kenë gjithashtu një garanci dy vjeçare.

Pajisjet e testimit dhe matjes

Ofertuesi duhet të përfshijë në ofertë një listë të pajisjeve të testimit dhe matjes, të cilat kërkohen për të siguruar shërbime të mirëmbajtjes normale të testimit dhe të vënies në punë të nivelit të parë.

Kapaciteti VCS

Kapaciteti i sistemit

1. Burimet e mëposhtme të komunikimit do të lidhen në sistem:

Artikulli	Sasia. për Instalimin
Pozicion i Punës ATC	5
Radio Kanali IP (VOIP) (M+STBY)	30
Kanalet e radios E&M me tela 4 (M+STBY)	4
Telefoni Linjat VOIP	20
Telefoni Linja analoge (MFC ose PABX)	10
Monitorim Teknik dhe Kontroll Sistemi	1

2. VCS do të ketë aftësi për të paktën 8 CWP (pozitë të punës së Kontrollorit) ku çdo CWP duhet të përmbajë:
 - a. TFT LCD Ekran Paneli me Prekje dhe Ngjyra (TSP) për akses te radio, telefon dhe intercom.
 - b. Një altoparlant për marrjen e audios nga kanalet e zgjedhura të radios dhe tingullin e ‘call chime’ .
 - c. Një prizë panel me dy portat për të lidhur pozicion instrumente si kufjet dhe aparatet.
 - d. CWP duhet të jetë i një dizajni ergonomik pa kërkesa të veçanta instalimi.
 - e. Panelet e ekranit me prekje, panelet e altoparlantëve dhe panelet e prizës duhet të furnizohen si njësi të veçanta për montimin e konsolës.
 - f. Pozicionet e punës së kontrolluesit duhet të dorëzohen me njësi fuqie 110-230 VAC.
3. Duhet të sigurohet një server i menaxhimit të sistemit të komunikimit zanor për të monitoruar dhe kontrolluar VCS. Sistemi përbëhet nga një server ose një Ëorkstation, një ekran LCD 23 inç me ekran të sheshtë dhe një printer lazer.
4. Ekranit, tastiera dhe miu i Serverit do të lidhen nëpërmjet një zgjeruesi KVM nga serveri në dhomën e të dhënave deri në dhomën e monitorimit.
5. Ky softuer duhet të ofrojë:
 - a. Baza e të dhënave
 - b. Rolet dhe Skenarët e Menaxhimit
 - c. Kufizimet e Operatorit
 - d. Funksionet Diagnostifikuese

- e. Panel Alarmi
- f. Sistem Rikonfigurimi
- g. Rikonfigurimi i Rutimit të thirrjeve
- h. Raport për konfigurimet
- i. Memorie e përhershme

6. Softueri i sistemit të menaxhimit në distancë të radiove do të ngarkohet gjithashtu në kompjuterin VCMS. RCS duhet të sigurojë kontroll dhe monitorim gjithëpërfshirës mbi radiot e vendosura në distancë. Çdo mosfunksionim i radios duhet të raportohet në çast dhe të kontrollohet mbi parametra të tillë si fuqia RF, thellësia e modulimit, niveli bazë të sinjalit etj, duhet të jetë në dispozicion nga të VCMS.

Kërkesat Funksionale

1. Konfigurimi dhe aktivizimi i misionit do të kryhet në stacionet e punës së mirëmbajtjes.
2. Ndryshimi i çdo konfigurimi ose misioni do të jetë i mundur pa ndërprerje komunikimi.
3. Ndryshimet e misionit do të konfirmohen manualisht në çdo pozicion operatori të realizuar pa kufizim kohor.
4. Skenari i mëparshëm i misionit të pozicionit të operatorit do të jetë operacional deri në konfirmimin e misionit të ri
5. Sistemi do të njohë pozicionin e operatorit të pambikëqyrur nëse nuk ka pajisje (kufje ose mikrofon) të lidhur me CWP. Audioja në hyrje do të drejtohet në altoparlantin e pozicionit dhe të gjitha thirrjet aktive do të lëshohen pas 30 sekondash.
6. Sistemi duhet të ketë mbrojtje me shumë nivele me fjalëkalim
7. Çdo funksion operacional do të aktivizohet ose duke shtypur tastin e dedikuar të funksionit ose duke shtypur një kod funksioni.

Pozicionet e punës së Kontrollorit (CWP)

Panelet e operatorit do të dorëzohen me një ndërfaqe grafike të përdoruesit të krijuar për fleksibilitet të madh dhe përdorim ergonomik. Paneli i Operatorit do të jetë në gjendje të shfaqë çelësat e Qasjes Direkte (DA) për komunikimin G/G, një bllok telefonik për telefonimin manual dhe butonat e hyrjes për 16 kanale të ndryshme radio. Për më tepër, paneli me prekje duhet të përmbajë çelësa për funksionet e telefonit dhe radios. Pajisja CWP nuk duhet të ketë pjesë lëvizëse.

Çdo CWP do të përmbajë pajisjet e mëposhtme:

Sasi a.	Arti kulli
1	Ekrani me prekje 12,1" (Pajisja e hyrjes me prekje)
1	Plug-in-Panel (siguron 2 fole për celularin ose kufjet për trajnerin dhe operatorin). PTT-ja e instruktorit do të anashkalojë PTT-në e operatorit

1	Celulari (me ndërprerës të inkorporuar PTT) - do të përdoret për komunikim telefonik
1	Ndërprerësi i këmbës (do të funksionojë paralelisht me çelësin PTT të lidhur me kufjet)
1	Moduli i altoparantit (kontrolli i volumit të altoparantit i rregullueshëm në altoparant) - do të përdoret për monitorimin e komunikimit telefonik dhe radio. Nëse janë të lidhur dy altoparantë, do të jetë e mundur të caktohet secili altoparant në një burim të dedikuar audio (p.sh. vetëm ajër/tokë ose tokë/ zë tokë).

Ndërfaqja grafike e përdoruesit

Ndërfaqja grafike e përdoruesit do të sigurojë komunikim të thjeshtë me sistemin. Një teknikë dritareje së bashku me një sistem që përdor menunë do të përdoren për shfaqjen dhe aksesin e sistemit. Pajisja e hyrjes me prekje (TED) do t'u sigurojë kontrollorëve të trafikut ajror akses me zë dhe kontroll në VCS dhe burimet e tij të komunikimit (p.sh. kanalet e radios, linjat telefonike dhe pozicionet e tjera të operatorit).

TED do të ketë një ekran TFT me një rezolucion prej 800x600 piksele, një shkëlqim prej 300 cd/m² dhe një raport kontrasti 300:1. Këndi i shikimit: nuk duhet të jetë më i vogël se $\square 50^\circ$ në drejtimin horizontal (në raportin e kontrastit 10:1). Pajisja duhet të sigurojë kohë të konfigurimit të faqes më pak se 60 ms. Teknologjia e prekjes së TED duhet të jetë rezistente analoge e cila është më e sigurt ndaj gabimeve të hyrjes

Kontroll i integruar i regjistrimit

Regjistrimi afatshkurtër duhet të jetë i disponueshëm në pozicionet për të mbajtur të paktën 30 minuta radio dhe 30 minuta komunikim telefonik. Këto të dhëna zanore të regjistruara do të mund të dërgohen në një stacion menaxhimi për arkivim.

CWP - FunkSIONET dhe veçoritë e Telefonisë dhe Intercom

Buton me akses të drejtpërdrejtë

Çdo CWP do të sigurojë aftësinë për të shfaqur dhe përdorur 80 çelësa të Qasjes Direkte (DA). Çelësat DA do të ofrojnë tregues të zënë të CWP-ve .

Buton me akses indirekte.

Çdo CWP do të ofrojë aftësinë për t'i mundësuar operatorit të inicojë një telefonatë me një grup të paracaktuar në tokë (ose një numri të paracaktuar grupësh) me anë të një numri telefoni, duke kryer thirrjen manualisht në tastjerën telefonike .

Përcjellja e thirrjeve.

Call Forwarding do të mundësojë një ridrejtim automatik të thirrjeve hyrëse tokësore/tokësore (G/G) në një pozicion tjetër operatori.

Transferimi i thirrjeve.

Nëpërmjet funksionit Call Transfer operatori do të jetë në gjendje të transferojë një thirrje G/G aktive ose në pritje në një destinacion tjetër.

Marrja e thirrjeve selektive.

Çdo operator do të jetë në gjendje të marrë një telefonatë që është në pritje në pozicione të tjera.

Konferenca.

Me anë të funksionit të Konferencës do të jetë e mundur që disa palë të mund të ndajnë një kanal të përbashkët komunikimi që u mundëson atyre të bisedojnë në të njëjtën kohë me njëri-tjetrin. VCS-ja do të mbështesë deri në 7 pjesëmarrës brenda një konference të vetme. Llojet e mëposhtme të konferencave do të mbështeten:

- Konferencë manuale: kryetari i konferencës do të jetë në gjendje të zgjedhë 6 pjesëmarrës për një konferencë. Përzgjedhja e pjesëmarrësve mund të bëhet duke përzgjedhur në mënyrë sekuenciale të gjithë anëtarët e kërkuar të konferencës pa pasur nevojë të presësh një përgjigje përpara se të telefonosh anëtarin e ardhshëm.
- Konferenca e paracaktuar: Lejon një grup të paracaktuar operatorësh të ndajnë një kanal të përbashkët komunikimi duke u mundësuar atyre të flasin njëkohësisht me njëri-tjetrin.
- Konferenca automatike: Aktivizon një konferencë pasi pranon ose aktivizon një telefonatë të dytë kur një tjetër është në vazhdim.

Mbajtja e thirrjes.

Me anë të funksionit Call Hold operatori do të jetë në gjendje të ndërpresë një telefonatë aktive pa pasur nevojë ta lëshojë atë ("vë në pritje") në mënyrë që të mund të vazhdojë thirrjen në një moment të mëvonshëm. Do të jetë e mundur të kalohet ndërmjet një përdoruesi aktiv dhe atij në "hold" (pritje).

Gjurmimi i Linjes.

Sistemi do të mbështesë gjurmimin e linjës, dmth. kur një operator zgjedh një grup specifik trunk për një telefonatë dalëse, sistemi automatikisht do të kërkojë një linjë të lirë brenda grupit dhe do ta kapë atë.

Monitorimi i pozicionit / Monitorimi i linjës.

Me anë të funksionit të monitorimit të pozicionit, një operator do të jetë në gjendje të dëgjojë audion e kombinuar të komunikimit G/G dhe A/G të pozicioneve të ndryshme të operatorit. Me anë të funksionit të monitorimit të linjës, një operator do të jetë në gjendje të dëgjojë një numër të ndryshëm linjash.

Përgjigje selektive në radhën e thirrjeve.

Në pajisjen e hyrjes me prekje për çdo telefonatë IA në pritje, do të sigurohet një përzgjedhës i dedikuar i përgjigjes së përbashkët (CA) që tregon identitetin e telefonuesit. Operatori mund të pranojë thirrje IA në pritje në çdo mënyrë.

Rithirrja e numrit të fundit.

Ky funksion do t'i lejojë operatorit të ritheksojë numrin e fundit të thirrur në tastierën telefonike duke shtypur një tast të vetëm. Ky funksion do të jetë i disponueshëm për llojet e linjave PABX dhe PSTN.

Realizim i thirrjeve me numeracion të shkurtuar .

Telefonimi me numeracion të shkurtuar do t'i mundësojë operatorit të iniciojë një telefonatë me qasje indirekte (IA) pa pasur nevojë të formojë kodin e plotë të aksesit. Destinacionet do të mund të arrihen duke thirrur një kod telefonik të shkurtuar dyshifror ose duke shtypur një tast të thirrjes së shpejtë.

CWP – Funksionet dhe veçoritë e radios

Karakteristikat e radios për aplikacione komplekse

VCS do të mbështesë veçori të avancuara për operacione të sigurta me radio:

1. Zgjedhja më e mirë e sinjalit (BSS) bazuar në llogaritjen dixhitale të cilësisë së audios, e integruar në VCS në të paktën 64 hapa.
2. Lidhja e frekuencës (simpleks dhe dupleks)
3. Tasti PTT në HMI të panelit
4. Ndërfaqja duhet të mbështesë të paktën 24 frekuenca në një pozicion operatori.

Modaliteti i monitorimit (Rx) / Modaliteti i trafikut (Tx)

Frekuencat e zgjedhura në modalitetin e monitorimit do të përgatiten për paraqitjen e zërit të marrë nga kjo frekuencë në pozicionin e operatorit pas zbulimit të Squelch. Frekuencat e zgjedhura në modalitetin e trafikut do të përgatiten për transmetim në aktivizimin e PTT në pozicionin e operatorit.

Kontrolli i PTT

Tipari Failsafe PTT do të ofrojë një afat kohor PTT të kontrolluar nga sistemi. Nëse një sinjal PTT është aktiv më shumë se një minutë në një kanal radio të caktuar, një alarm do të gjenerohet dhe shfaqet në TMCS. Kjo do të sigurojë akses të vazhdueshëm në frekuenca, edhe nëse frekuencat janë të kyçura nga çelësat PTT me defekt (p.sh. nga kufjet ose çelësat e këmbëve).

Tregues PTT aktiv diku tjetër

PTT aktive do të tregohet në të gjitha pozicionet e operatorit që kanë këtë frekuencë të konfiguruar.

Ndalim i Squelch

Squelch Break do të sigurojë një tregues të thirrjeve radio hyrëse në të gjitha pozicionet që kanë konfigurimin e frekuencës përkatëse.

Tregimi i kanalit radiofonik "Jashtë shërbimit".

